

SEKTORI I POLITIKAVE ADMINISTRATIVE

1. Misioni i Sektorit

Sektori i Politikave Administrative ka për mision planifikimin dhe koordinimin efektiv të punës së Njësive Administrative dhe Lagjeve në përputhje me programet dhe politikat e Bashkisë Elbasan. Ai identifikon nevojat e zhvillimit të politikave vendore, rekomandon komponentë strategjike dhe siguron bashkërendimin ndërmjet strukturave të administratës për përmbushjen e objektivave të vendosura.

Sektori është përgjegjës për administrimin e çdo çështjeje që lidhet me funksionimin dhe performancën e 12 Njësive Administrative dhe 6 Lagjeve të Bashkisë Elbasan, duke garantuar një qasje koherente, efikase dhe të orientuar drejt qytetarit.

2. Objektivat Kryesore të Sektorit

- Të garantojë menaxhim efektiv të veprimtarive dhe përmbushjen e detyrave sipas planit vjetor të Bashkisë.
- Të sigurojë koordinim të qëndrueshëm ndërmjet Njësive Administrative, Lagjeve dhe Drejtorive përkatëse.
- Të bashkëpunojë ngushtë me Drejtorinë e Monitorimit dhe Shërbimeve Urbane për ndjekjen dhe zgjidhjen e problematikave lokale.
- Të mbajë korrespondencë institucionale me përfaqësues të KQZ-së gjatë proceseve zgjedhore.
- Të zhvillojë politika administrative efikase, të mbështetura në transparencë dhe performancë.

3. Harta e Proceseve të Punës

Emërtimi i procesit	Koordinimi efektiv i problemeve që kanë Njësitë Administrative dhe Lagjet
Nën-proceset	Evidentimi i problematikave ditore; Sistematizimi sipas tematikës; Përcjellja për zgjidhje; Vlerësimi i përfundimit.
Objektivi i procesit	Sigurimi i zgjidhjes optimale dhe në kohë të problematikave nga drejtoritë përkatëse.
Struktura përgjegjëse	Spektori i Politikave Administrative
Përshkrimi i veprimtarisë	Spektori mbledh çdo ditë informacione nga Njësitë dhe Lagjet, i klasifikon sipas tematikës, i përcjell për zgjidhje në drejtoritë përkatëse, ndjek e raporton mbi ecurinë e zgjidhjes.
Struktura të përfshira	Drejtoritë e Bashkisë, Njësitë Administrative, Lagjet, Agjencitë e vartësisë
Kuadri ligjor	Ligji 139/2015; Ligji 44/2015; Ligji 146/2014; Vendimi 384/2016; etj.
Afati i zbatimit	Sipas marrëveshjeve me drejtoritë dhe afateve kohore të Njësive ose Lagjeve.

4. Organizimi Administrativ i Bashkisë Elbasan

4.1 Lagjet e Qytetit të Elbasanit

Sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 33, datë 25.03.2016, qyteti i Elbasanit ndahet në 6 lagje.

Nr. Lagjeje	Lagjet përbërëse
Lagja nr. 1	Kongresi i Elbasanit, Luigj Gurakuqi, Beqir Dardha, Emin Matraxhiu
Lagja nr. 2	Qemal Stafa, Brigada 17 S, Çlirimi, Sul Papri, Shënkoll
Lagja nr. 3	Skënderbej, 28 Nëntori, Dyli Haxhire, Syrja Dylgjeri
Lagja nr. 4	Vullnetari, Partizani, Aqif Pasha, Kala, Visarion Xhuvani
Lagja nr. 5	11 Nëntori, Haxhias
Lagja nr. 6	5 Maji

4.2 Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan

Bashkia përbëhet nga 12 Njësi Administrative.

Nr	Njësia Administrative	Sipërfaqja (km²)	Nr. i Fshatrave	Fshatrat përbërëse
1	Bradashesh	56.0	17	Bradashesh, Balez Lart, Balez Poshte, Kusarth, Kozan, Karakullak, Letan, Rrile, Shtemaj, Ulen, Katund i Ri, Fikas, Petresh, Shëmhill, Shijon, Reçan, Gurabardh
2	Shushicë	106.6	9	Shushicë, Shelcan, Mlizë, Hajdaran, Fush-Bull, Vasjan, Polis i Vogël, Polis Valë, Vreshtaj
3	Shirgjan	21.6	7	Shirgjan, Bathes, Bujqes, Jagodinë, Kuqan, Kryezjarr, Mjekës
4	Papër	102.0	13	Papër, Broshkë, Murras, Valas, Vidhas, Pajun, Bizhute, Papër-Sallak, Vidhas-Hasgjel, Lugaj, Jatesh, Balldre, Ullishtaj
5	Gjergjan	27.9	7	Gjergjan, Bujaras, Gjonmë, Kështjellë, Kodër-Bujaras, Muriqan, Thanë
6	Labinot-Fushë	49.0	6	Labinot-Fushë, Godollesh, Griqan i Sipërm, Griqan i Poshtëm, Xibrake, Mengel
7	Labinot-Mal	105.7	10	Labinot-Mal, Guri Zi, Sericë, Lamollë, Benë, Lugaxhi, Qafë, Qerret, Shmil, Dritas
8	Gjinar	89.1	11	Gjinar, Lleshan, Valësh, Pashtresh, Derstilë, Lukan, Sterstan, Xibresh, Maskarth, Kaferr, Pobrat
9	Tregan	57.4	12	Tregan, Blerimas, Bizhdan, Cikallesh, Gurisht, Kaçivel, Kyçyk, Muçan, Shinavlash, Shilbater, Trepsenisht, Tudan
10	Funar	76.6	9	Branesh, Bixellë, Preç e Sipërme, Cerujë, Korrë, Mollagjesh, Krrabë e Vogël, Preç e Poshtme, Stafaj
11	Gracen	56.8	9	Gracen, Plangaricë, Terbaç, Bodin, Shingjin, Gjorm, Pajengë, Mamel, Dopaj
12	Zavalinë	101.1	6	Zavalinë, Seltë, Kamiçan, Joronisht, Nezhan, Burrisht

5. Përfundim

Sektori i Politikave Administrative është një hallkë kyçe e funksionimit të Bashkisë Elbasan, që garanton bashkërendim të plotë midis administratës qendrore të bashkisë dhe strukturave territoriale. Puna e tij ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së shërbimeve, adresimin e problematikave qytetare dhe zbatimin e politikave vendore në nivel lagjesh dhe njësisish administrative.